

## **Hapet thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz, në Gjermani, për semestrin e parë të vitit akademik 2024 - 2025.**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz, për semestrin e parë të vitit akademik 2024 - 2025.

<https://www.hs-koblenz.de/rac/index>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime, internship;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (1 semestër);  
- Master (1 semestër).

### **Fushat e studimit:**

- Informatikë Ekonomike;
- Administrim biznesi;
- Gjuhë e huaj;

Për më shumë informacion mbi lëndët në gjuhën angleze klikoni në adresën:

[https://www.hs-koblenz.de/fileadmin/media/user\\_upload/t3\\_mitarbeiter/-Courses\\_taught\\_in\\_English\\_-\\_RheinAhrCampus\\_-\\_Preliminary\\_List\\_-\\_SuSe\\_2024\\_02.pdf](https://www.hs-koblenz.de/fileadmin/media/user_upload/t3_mitarbeiter/-Courses_taught_in_English_-_RheinAhrCampus_-_Preliminary_List_-_SuSe_2024_02.pdf)

Për informacion mbi Internshipin e ofruar për studentët klikoni në adresën:

<https://www.hs-koblenz.de/rac/international-programs/international-students/exchange-students/academic-internship>

Studentët që aplikojnë për Internship duhet që krahas internshit (15 ECTS) të kryejnë edhe lëndë akademike për të përmbushur 30 ECTS.

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| <b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b><br>( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> ) | <b>Kompensimi</b> |
|--|-------------------|
| <b>Midis 100 dhe 499 KM</b>  | 180 EUR           |
| <b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>   | 275 EUR           |
| <b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>  | 360 EUR           |
| <b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>  | 530 EUR           |
| <b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>  | 820 EUR           |
| <b>8000 KM ose më shumë</b>  | 1100 EUR          |

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Bachelor:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (gjuhë angleze ose gjermane në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)
- Dokumenti Learning Agreement\* (studentët duhet të plotësojnë minimalisht 30 ECTS dhe në UT duhet të njihen minimalisht 20 ECTS)

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Nëse studentit kryen ndryshime “During mobility”, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

- CV (në gjuhën angleze/ gjermane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit);

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit);

-Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht/ Gjermanisht në varësi të programit të studimit);

-Learning Agreement\* (studentët duhet të plotësojnë minimalisht 30 ECTS dhe në UT duhet të njihen minimalisht 20 ECTS);

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Nëse studentit kryen ndryshime “During mobility”, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

Afati për aplikim: **13 Maj 2024**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!